

Ndihma për familjet e goditura nga tërmeti nga Diakonia Agapes



Gjatë muajit maj 2020, Zyra “Shërbimi i Dashurisë” (Diakonia Agapes), e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, ndihmoi 56 familje të goditura nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, me pako ushqimore, me materiale për higjienën, si edhe me artikuj të tjerë. Kjo u bë e mundur me mbështetjen financiare të International Orthodox Christian Charities (IOCC) dhe Global Giving.

Familjet ishin të shpërndara në Tiranë (Pezë, Baldushk dhe Njësia nr. 11), Durrës (Rrushkull, Spitalë e Durrës) dhe Belsh, ku shumica e tyre jetojnë akoma në çadra. Kështu, u ndihmuan në total rreth 250 persona me artikuj bazë ushqimore e higjienikë, soba druri, batanije e çarçafë etj. Familjet dhe nevojat e tyre u identifikuan në bashkëpunim me bashkitë dhe njësitë administrative, si dhe me Kishën Orthodhokse në Durrës.





— orthodoxalbania.org